

Z. Bledar Mustafaraj, nga muaji Qershor 2024 kryen detyrën e drejtorit të Drejtorisë Juridike në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Ka përfunduar studimet e larta në vitin 2001, në degën Drejtësi, ndërsa gjatë viteve 2002-2005 ka ndjekur programin e Shkollës së Magjistraturës, profili prokuror.

Përgjatë periudhës 2012-2016 ka ndjekur studimet e doktoraturës dhe në muajin Prill 2016 ka marrë gradën “Doktor i shkencave”.

Në muajin Tetor 2021 ka fituar titullin “Avokat”.

Nga data 11.10.2004 deri në datë 19.03.2021 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Gjatë kësaj periudhe, ka kryer detyra të ndryshme në këtë institucion si pjesëtar dhe drejtues i Njesisë së Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit, i seksionit për hetimin e veprave penale kundër jetës, drejtësisë dhe zgjedhjeve të lira, i seksionit të posaçëm të përkohshëm për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, veprave penale në sferën ekonomike, veprave penale të kryera nga subjektet e posaçme, etj. Gjatë periudhave 2008-2009 dhe Tetor 2015-Shkurt 2019, ka kryer detyrën e Zëvendësdrejtuesit të kësaj Prokurorie.

Nga data 19.03.2021 deri në datë 30.11.2023 ka kryer detyrën e Magjistratit të komanduar në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Z. Bledar Mustafaraj është angazhuar si pedagog (lektor) part-time për lëndët “E drejta e procedurës penale”, “Bazat e Kriminologjisë Klinike”, “E drejtë publike”, “E drejtë penale. Pjesa e posaçme” dhe “Ekzekutimi i vendimeve penale” në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, nga viti 2014 e aktualisht.

Nga viti 2019 e në vijim, është angazhuar si ekspert i jashtëm pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, gjatë ndjekjes së procedurave të akreditimit dhe riakreditimit të programeve të ndryshme të disa institucioneve të arsimit të lartë. Gjithashtu, është angazhuar në periudha të caktuara si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, OSCE Presence in Albania, Këshillit të Evropës, Kongresit Rinor Kombëtar, etj.

Z. Bledar Mustafaraj ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh trajnimi të realizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga organizma e subjekte të tjerë, brenda e jashtë vendit.

Në funksion të kërkimit shkencor, ka marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera, brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet paraqitjes së punimeve të ndryshme. Është autor i disa punimeve, artikujve dhe referateve profesionale dhe akademike.

Zotëron gjuhët angleze, frënge, spanjolle dhe italiane.